

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **302-26-1256-2-2-1**

Sa i përket tenderit për “ **Mirëmbajtja e Softuerit për menaxhimin e auditimit – SITA**”

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>Tretek SH.P.K.</b>
NUI	<b>810853821</b>
Adresa	<b>Rr.Astrit Rrushi Obj.Pika Mati 1</b>
Vendi	<b>Prishtinë</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>+38349642227</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Lirim Sylejmani</b>
Adresa elektronike	<b>tretekshpk@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>29.05.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike



### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 16.03.2026
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara – 09.04.2026
- Proces verbali i hapjes së Tenderëve – 16.04.2026
- Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues – 13.05.2026
- Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim – 20.05.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Jemi njoftuar përmes platformes elektronike të prokurimit publik me hapjen e tenderëve

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Vendimi i autoritetit kontraktues në raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.  
Te bashkangjitur në këtë ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 7** - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
**Neni 27** - Dosja e Tenderit  
**Neni 28** - Specifikimet teknike  
**Neni 51** - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes  
**Neni 59** - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve  
**Neni 60** - Kriteret për Dhënien e Kontratës  
**Neni 69** - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar,

Bazuar në dispozitat e nenit 109(2) të LPP-së, parashtrojmë këtë **Ankesë** ndaj Vendimit të AK-së i pranuar nga OE me datën 13-05-2026 ("**Vendimi i Ankimuar**") përmes së cilit është Refuzuar Kërkesa e datës 18-05-2026 në kuptim të së cilës është propozuar kthimi i tenderit në ri-vlerësim ashtu që pas rivlerësimit **Tretek SH.P.K.** si ofertues të përgjegjshëm dhe të na ftoj për nënshkrim të kontratës.

Në vijim po paraqesim pretendimet tona ankimore që kemi dorëzuar gjatë kërkesës për ri-shqyrtim e që me datën **20.05.2026** njoftohemi nga AK-ja rreth refuzimit të kërkesës për rishqyrtim.

### **PRETENDIMET ANKIMORE**

1. Në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për kontratë, tek kërkesa 6.4, është kërkuar qartazi:

*e. **Kërkesat** 6.4 Një (1) Menaxher / udhëheqës të projektit me përvojë minimum 5 vjeçare dhe prej tyre 1 vit përvojë pune për një projekt softuerik në fushën e auditimit të dokumentuar (vërtetim mbi këtë përvojë) ose në dy projekte të ngjashme në madhësi dhe kompleksitet me SITA Shkollimi i kërkuar : shkollim universitar në drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike.*

GOE i shpërblyer me kontratë nga AK nuk e ka përmbushur këtë kërkesë. Konkretisht, GOE ka propozuar znj. **G.G.** në pozitën e Menaxheres së projektit. Nga diploma e bashkangjitur rezulton se e njëjta ka përfunduar studimet universitare në drejtimin **Telekomunikacion**, duke fituar titullin Inxhinierë Elektrike në vitin 2013.

Megjithatë, kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit është specifike dhe kërkon shkollim universitar në **drejtimit e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike**.

Të diplomuarit në drejtimin **Telekomunikacion** fitojnë njohuri për projektimin dhe menaxhimin e rrjetave LAN dhe WAN, si dhe përdorimin e teknologjive të lidhjes si Wi-Fi dhe Bluetooth (*sipas provës 1, seksioni 15. Kompetencat e fituara nga të diplomuarit Baçelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, Departamenti Telekomunikacion*) e jo në zhvillim të sistemeve softuerike, inxhinieri kompjuterike që përbëjnë fushat drejtpërdrejt relevante për natyrën e kësaj kontrate (*sipas provës 1, seksioni 19. Kompetencat e fituara nga të diplomuarit Baçelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike*).

**Prova 1:** Dokument sqarues mbi kompetencat e fituara nga të diplomuarit në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.pdf

Sikurse një inxhinier i telekomunikacionit nuk mund të konsiderohet profesionalisht kompetent për zhvillimin, arkitekturën dhe mirëmbajtjen e sistemeve komplekse softuerike vetëm pse mban titullin “inxhinier”, po aq i pabazuar dhe joprofesional do të ishte edhe pretendimi se një inxhinier kompjuterik mund të projektojë dhe menaxhojë sisteme të avancuara telekomunikuese pa formimin specifik akademik dhe profesional në atë fushë. Fakti që të dy profilet i përkasin kategorisë së përgjithshme të “inxhinierisë” nuk i bën ato ekuivalente, as të këmbyeshme ndërmjet vete. Përkundrazi, bëhet fjalë për fusha të ndryshme profesionale, me kurrikula të ndara, objektiva të ndryshme akademike dhe kompetenca substancialisht të ndryshme. Pranimi i një interpretimi të tillë të zgjeruar dhe arbitrar do të nënkuptonte se vetë kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktues humb çdo kuptim profesional dhe juridik, pasi atëherë çdo diplomë inxhinierike pavarësisht natyrës së saj do të mund të konsiderohej artificialisht “relevante” për një kontratë të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve softuerike.

Një qasje e tillë jo vetëm që bie ndesh me logjikën profesionale dhe standardet akademike, por përbën edhe deformim të drejtpërdrejtë të kriterit të tenderit pas hapjes së ofertave, duke cenuar rëndë parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik.

Për të mbështetur këtë fakt, në vijim bashkëngjisim syllabuset përkatëse të programeve akademike për vitet akademike 2008/09 për dy drejtimit/programet studimore “Telekomunikacion” dhe “Inxhinieri Kompjuterike” (*prova 2*) nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - Universiteti i Prishtinës, nga të cilat shihet qartë se bëhet fjalë për programe të ndara akademike, me përmbajtje mësimore, profil profesional dhe fokus thelbësisht të ndryshëm

**Prova 2:** Syllabuset - Telekomunikacion / Inxhinieri Kompjuterike.pdf

Po ashtu, edhe nga të dhënat zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (*prova 3*) rezulton qartë se programet “Telekomunikacion” dhe “Inxhinieri Kompjuterike” trajtohen si programe të ndara dhe të veçanta akademike.

**Prova 3:** 2011-073-Vendim-FIEK.pdf

Rrjedhimisht, konsiderojmë se kandidati i propozuar nuk e përmbush kërkesën minimale të kualifikimit profesional të përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues, duke e pranuar këtë kandidat si të përgjegjshëm dhe duke e vlerësuar ofertën e GOE-së së shpërblyer si të përgjegjshme, ka vepruar në kundërshtim nenet 7, 27, 28, 51, 59, 60, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

2. Në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për kontratë, tek kërkesa 6.5, është kërkuar qartazi:

*f. **Kërkesat 6.5** Një (1) Arkitekt i Sistemit me minimum 5 vite përvojë profesionale në projektimin dhe ndërtimin e arkitekturës për sisteme të bazuara në ASP.NET, .NET C# dhe MS SQL Server. Shkollimi i kërkuar: shkollim universitar në drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike, Certifikuar në Microsoft Certified: Azure Solutions Architect Expert ose certifikim ekuivalent të nivelit profesional/expert në arkitekturë (AWS Certified Solutions Architect – Professional, TOGAF*

GOE i shpërblyer me kontratë nga AK nuk e ka përmbushur këtë kërkesë. Konkretisht, GOE ka propozuar z. **L.H.** në pozitën e Arkitekt Softueri. Nga diploma e bashkangjitur rezulton se i njëjti ka përfunduar studimet universitare në drejtimin **Automatikë me Elektronikë**, duke fituar titullin Inxhinier Elektroteknikës në vitin 2004.

Megjithatë, kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit është specifike dhe kërkon shkollim universitar në **drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike**.

Të diplomuarit në drejtimin **Automatikë me Elektronikë** fitojnë njohuri të thella teorike dhe praktike mbi funksionimin e sistemeve elektronike, përfshirë komponente elektronike të fuqisë së ulët dhe të lartë, qarqe të integruar elektronike dhe optoelektronike, si dhe sisteme për përpunimin digjital të të dhënave dhe kontrollin automatizuar të proceseve industriale (*sipas provës 4, seksioni 3. Kompetencat e fituara nga të diplomuarit në Automatikë me Elektronikë (Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës - dega: Automatikë me Elektronikë)* e jo në zhvillim të sistemeve softuerike, inxhinieri kompjuterike që përbëjnë fushat drejtpërdrejt relevante për natyrën e kësaj kontrate (*sipas provës 4, seksioni 19. Kompetencat e fituara nga të diplomuarit Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Kompjuterike*).

**Prova 4:** Dokument sqarues mbi kompetencat e fituara nga të diplomuarit në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.pdf

Sikurse një inxhinier i profilit Automatikë me Elektronikë nuk mund të konsiderohet profesionalisht kompetent për zhvillimin, arkitekturën dhe mirëmbajtjen e sistemeve komplekse softuerike vetëm pse mban titullin “inxhinier”, po aq i pabazuar dhe joprofesional do të ishte edhe pretendimi se një inxhinier kompjuterik mund të projektojë dhe menaxhojë sisteme të automatizimit industrial, qarqe elektronike apo sisteme të kontrollit pa formimin specifik akademik dhe profesional në atë fushë. Fakti që të dy profilet i përkasin kategorisë së përgjithshme të “inxhinierisë” nuk i bën ato ekuivalente, as të këmbyeshme ndërmjet vete. Përkundrazi, bëhet fjalë për fusha të ndryshme profesionale, me kurrikula të ndara, objektiva të ndryshme akademike dhe kompetenca substancialisht të ndryshme. Pranimi i një interpretimi të tillë të zgjeruar dhe arbitrar do të nënkuptonte se vetë kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktues humb çdo kuptim profesional dhe juridik, pasi atëherë çdo diplomë inxhinierike, pavarësisht natyrës së saj, do të mund të konsiderohej artificialisht “relevante” për një kontratë që lidhet me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve softuerike.

Një qasje e tillë jo vetëm që bie ndesh me logjikën profesionale dhe standardet akademike, por përbën edhe deformim të drejtpërdrejtë të kriterit të tenderit pas hapjes së ofertave, duke cenuar rëndë parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe vlerësimit objektiv në procedurat e prokurimit publik.

Prej vitit 1988 deri 2005 Fakulteti i Elektroteknikës në Prishtinë e zhvilloi mësimin në katër profile arsimore, siç janë:

1. Sistemet elektroenergjetike,

2. Energjetika industriale,
3. Telekomunikacioni me informatikë dhe
4. Automatika me elektronikë

Në vitin 1988 Fakulteti Teknik ndahet në tri Fakultete: Fakultetin e Elektroteknikës, Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës dhe Fakultetin e Makinerisë.

Kuvendi i Kosovës, më 25 shkurt 1988, miratoi Ligjin për themelimin e Fakultetit Elektroteknik në Prishtinë ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 28/88).

Prej vitit 1988 Fakulteti i Elektroteknikës në Prishtinë e zhvilloi mësimin në katër profile arsimore, siç janë:

1. Sistemet elektroenergjetike,
2. Energjetika industriale,
3. Telekomunikacioni me informatikë dhe
4. Automatika me elektronikë.

#### **Prova 5: Dokumenti 35 (Universiteti i Prishtinës 1970 - 2005)**

<https://fiek.uni-pr.edu/desk/inc/media/C5F19FED-C351-4473-8F40-C6E7865526C9.pdf>

Duke marrë parasysh se diploma e kandidatit i përket periudhës 1997-2003, **nuk mund** të konsiderohet automatikisht se ky profil akademik është i njëjtë apo relevant me drejtimin e Inxhinierisë Kompjuterike. Në atë periudhë, programet studimore në Fakultetin e Elektroteknikës kanë qenë të ndara sipas profileve specifike, secila me përmbajtje mësimore dhe fokus profesional të ndryshëm. **Si drejtim që mund të konsiderohet më i afërt me Inxhinierinë Kompjuterike në atë kohë ka qenë "Telekomunikacion me Informatikë"**, pasi ky program përfshinte edhe komponentë nga fusha e informatikës dhe kompetenca të ngjashme me ato të Inxhinierisë Kompjuterike, siç dëshmohet edhe nga përshkrimi zyrtar i kompetencave të fituara nga të diplomuarit në këtë program (*sipas provës 6, seksioni 4. Kompetencat e fituara nga të diplomuarit në Telekomunikacion me Informatikë (Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës - dega: Telekomunikacion me Informatikë).*

#### **Prova 6: Dokument sqarues mbi kompetencat e fituara nga të diplomuarit në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.pdf**

Për të mbështetur këtë fakt, në vijim bashkëngjisim syllabusin përkatës i programit akademik të vitit 1996/97 për drejtimin/programin **Automikë me Elektronikë (prova 7)** nga Fakulteti i Elektroteknikës - UP, ku shihet qartë se bëhet fjalë për profil të ndarë akademik me përmbajtje dhe fokus thelbësisht të ndryshëm.

#### **Prova 7: Syllabusi - Automatike.pdf**

Rrjedhimisht, konsiderojmë se kandidati i propozuar nuk e përmbush kërkesën minimale të kualifikimit profesional të përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues, duke e pranuar këtë kandidat si të përgjegjshëm dhe duke e vlerësuar ofertën e GOE-së së shpërblyer si të përgjegjshme, ka vepruar në kundërshtim nenet 7, 27, 28, 51, 59, 60, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik.

## KËSISOJ,

Konstatimin ynë është se kriteri i përcaktuar nga AK-ja për “shkollim universitar në drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike” për dy pozitat “e. Kërkesat 6.4 Një (1) Menaxher / udhëheqës të projektit” dhe “f. Kërkesat 6.5 Një (1) Arkitekt i Sistemit” **duhet të interpretohet në përputhje me natyrën e kontratës**, e cila lidhet me mirëmbajtjen e një sistemi softuerik. Kjo nënkupton se profilet akademike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me *fushën e informatikës (kompjuterikës)*: *inxhinierisë kompjuterike apo shkencave kompjuterike - me specializim në zhvillim softueri* duhet të konsiderohen si përmbushje e kriterit.

Arsyetimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim (*vendimi i datës 20.05.2026*) nuk qëndron. Nga vetë formulimi i kriterit “shkollim universitar në drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike” kuptohet se AK ka kërkuar kualifikime universitare që i përkasin fushës së Inxhinierisë Kompjuterike apo Shkencave Kompjuterike.

Po të kishte për qëllim të pranonte çdo drejtim të inxhinierisë, AK do ta formulonte kriterin thjesht si “shkollim universitar në fushën e inxhinierisë”, **pa e lidhur atë me “shkencat kompjuterike”**. Përfshirja e termit “shkencave kompjuterike” në të njëjtin kriter tregon qartë se kërkesa është orientuar drejt profileve akademike të fushës së zhvillimit softuerik dhe jo drejt të gjitha disiplineve inxhinierike pa dallim. Për këtë arsye, interpretimi i AK-së se kriteri përmbushet nga çdo diplomë inxhinierike, pavarësisht fushës së specializimit, nuk mbështetet në formulimin e kriterit dhe as në qëllimin e tij në raport me objektin e kontratës, i cili ka të bëjë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve softuerike.

Andaj, pretendimet e OB-së janë të pabazuara, për faktin se kërkesat e Dosjes së Tenderit kanë qenë të qarta dhe të përcaktuara saktësisht nga Autoriteti Kontraktues. Në këto kërkesa nuk janë përfshirë fushat e pretenduara nga ankuesi, por është kërkuar vetëm **shkollim universitar në drejtimet e inxhinierisë apo shkencave kompjuterike**, pa specifikim të ndonjë fushe të caktuar. Gjithashtu, edhe përvoja e punës e paraqitur nga OE-ja është vlerësuar dhe pranuar nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.


1. Kërkesa për rishqyrtim; dhe
2. Letra standarde për sqarimin e dosjes së tenderit.

Në bazë të asaj që u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar mund të paraqesë në çdo rast një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-se.

Më datë: 20.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit  
Avni Zuka



**Vetë formulimi i kriterit nuk i referohet në mënyrë të përgjithshme “fushës së inxhinierisë”, por “drejtimeve të inxhinierisë kompjuterike apo shkencave kompjuterike”. Në interpretimin e zakonshëm gjuhësor dhe logjik të këtij formulimi, termi “kompjuterike” lidhet me të dy kategoritë e përmendura, përkatësisht me drejtimet e inxhinierisë kompjuterike dhe me drejtimet e shkencave kompjuterike.**

**Pranimi i interpretimit të AK-së do të çonte në një rezultat absurd dhe juridikisht të papranueshëm, ku çdo diplomë inxhinierike, pavarësisht specializimit, do të konsiderohej automatikisht e pranueshme. Në këtë rast, do të mund të konsideroheshin të pranueshme edhe profile të tilla si ndërtimtaria, makineria, energjetika, automatikë, elektronikë, telekomunikacion, teknologjia ushqimore apo fusha të tjera që nuk kanë asnjë lidhje**

**profesionale me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve softuerike. Një interpretim i tillë jo vetëm që e zhvlerëson kriterin e vendosur nga vetë AK-ja, por në praktikë e bën atë pa asnjë efekt juridik dhe profesional.**

Duke pasur parasysh natyrën e kontratës, vlerësimi i ofertave pritet të jetë kryer nga një komision profesional i fushës së kompjuterikës, i cili duhet ta njohë pa asnjë dilemë dallimin thelbësor ndërmjet “Inxhinierisë së Përgjithshme” dhe “Inxhinierisë Kompjuterike”. Megjithatë, mënyra se si është trajtuar ky kriter tregon se ky dallim ose nuk është kuptuar siç duhet, ose është shpërfillur plotësisht gjatë procesit të vlerësimit. Një veprim i tillë jo vetëm që bie ndesh me kërkesat e qarta të Dosjes së Tenderit, por ngre dyshime serioze mbi profesionalizmin, objektivitetin dhe kompetencën teknike të ushtruar gjatë vlerësimit të ofertave. Është vështirë të pranohet se një komision me ekspertizë në këtë fushë mund të ngatërrojë dy profile akademike që kanë përmbajtje, orientim dhe kompetenca profesionale dukshëm të ndryshme.

Ne kemi kërkuar nga AK në përputhje me dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe me qëllim të vlerësimit objektiv, të drejtë dhe të bazuar në fakte të ofertave, t’i drejtohen zyrtarisht Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - UP (FIEK) për të kërkuar sqarim profesional lidhur me atë nëse programet studimore “Telekomunikacion” dhe “Automatikë me Elektronikë”, për nga përmbajtja akademike dhe profili profesional, mund të konsiderohen të ngjashme apo relevante me drejtimin e Inxhinierisë Kompjuterike apo Shkencave Kompjuterike.

Megjithatë, AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim profesional nga institucioni kompetent akademik, por ka pranuar se kriteri është përmbushur vetëm mbi bazën e titullit të përgjithshëm “Inxhinier”. Një vlerësim i tillë është i paplotë dhe joobjektiv, pasi nuk merr parasysh përmbajtjen akademike, kompetencat profesionale dhe relevancën e programeve studimore në raport me kërkesat konkrete të kontratës.

Duke u bazuar në të gjitha shkeljet e lartpërmendura, **kërkojmë nga OSHP-ja që:**

**I. Ta shpallë ankesën tonë të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim**, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që, në përputhje Ligjin për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik, të anulojë vendimin e mëparshëm dhe të ftojë Tretak SH.P.K. për nënshkrimin e kontratës si operatori ekonomik me ofertën më të përgjegjshme.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës si dhe përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës:** Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës dhe ankesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

Fitimet e pritura: Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) 2011-073-Vendim-FIEK
- i) Dokument sqarues mbi kompetencat e fituara nga të diplomuarit
- j) Syllabuset - Telekomunikacion Inxhinieri Kompjuterike
- k) Syllabusi - Automatike

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

